




Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot.	01-555/4
Dep.		Bi. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. i tag		Data	
Broj stranica	02	Datum	12.02.2014
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 11.02.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-4409/13 për z.Zahir Musa–Drejtor Mjeksor i Spitalit Rajonal Mitrovicë, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4409-13, për Zyrtarin e lartë, z. Zahir Musa – Drejtor Mjeksor në Spitalin Rajonal të Mitrovicës – Ministria e Shëndetësisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Zahir Musa fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtari i lartë, z.Zahir Musa, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkua të përfshijnë situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Musa, në Agjencinë kundër Korrupcionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-451-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, Ordinanca Specialistike "Oftamolog", z.Musa, është tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar të këtij biznesi, dhe ka emruar një "person të besuar" në këtë funksion, ashtu siç e parashev edhe ligji. Këtë për shkak se z.Musa vazhdon të ushtron funksionin e tij publik, si Drejtor i Mjeksor i Spitalit Rajonal të Mitrovicës – Ministria e Shëndetësisë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit

